



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PËR

SHPLLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR EMËRIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË LIÇENSUAR, TË CILËT DO TË KRYEJNË AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTITË POLITIKE PËR VITIN KALENDARIK 2018

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 27.03.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

OBJEKT: Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa a, të ligjit nr. 10019, datë 29.02.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 15/2, pika 2, germa c, neni 23/2, pika 2 dhe neni 23/3 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.02.2011 dhe Udhëzimi i Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nr. 8, datë 25.03.2009 "Për miratimin e kriterëve dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore" i ndryshuar.



Nr. 112 i Vendimit data 27.03.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike;

V Ë R E N:

Në mbështetje të nenit 23/2, pika 2 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të emërojë me short për çdo parti politike, ekspertë kontabël të licencuar të cilët do të auditojnë fondet e përfuara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2018.

Sipas shkresës protokolluar me nr.18/1, datë 21.01.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Partitë Politike të regjistruara në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë 128 parti. Nga verifikimi bazuar në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 15 parti politike nuk kanë të deklaruar emrin e kryetarit të partisë politike. Me miratimin nga Kuvendi të ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, prej vitit 2000, partitë politike kanë patur detyrimin për depozitim të emrit të Kryetarit në Regjistrin e Gjykatës, dhe kundrejt vërtetimit të lëshuar nga Gjykata, ku pasqyrohej ndër të tjera dhe emri i kryetarit, Partia Politike regjistrohej si subjekt zgjedhor në KQZ. Mungesa në regjistrin për këto 15 parti politike, i emrit të kryetarit, do të thotë se të paktën nga viti 2000 e deri tani këto parti nuk kanë paraqitur kërkesë për regjistrim si subjekt zgjedhor, dhe nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet e zhvilluara në këtë periudhë 18 vjeçare. Duke qene se qëllimi kryesor për krijimin dhe funksionimin e një partie politike është pjesëmarrja në zgjedhje, për të konkurruar, nëpërmjet platformave dhe programeve, mospjesëmarrje për një periudhë 18 vjeçare i bën këto parti pa qëllim dhe pa aktivitet financiar dhe duhet të përjashtohen nga shorti për caktimin e auditit financiar për auditimin e fondeve për vitin kalendarik 2018.

Me vendimin nr.1036 Akti 11.12.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur sigurimin e padisë duke pezulluar dhe ndaluar kryerjen e të gjitha veprimtarive juridike,financiare dhe organizative brenda Partisë Politike "Lista e Barabartë", me initiale "Libra" si dhe çdo veprim bankar dhe veprimet të tjera me të gjitha institucionet e treta në emër të Partisë "Libra" të shtetasit Endri Tafani dhe personave të autorizuar prej tij. Në këtë rast Partia Politike "Lista e Barabartë",duhet të përjashtohet nga shorti për caktimin e ekspertit kontabël të licencuar për auditimin e fondeve për vitin kalendarik 2018.

Pra, parti politike të cilat duhet të auditohen për fondet e përfuara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2018 nga ekspertët kontabël të licencuar janë 112.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i kërkoi Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar listën e ekspertëve të cilët plotësonin kushtet e parashikuara në dispozitat e ligjit për partitë politike. Me shkresën nr.20/1, datë 21.01.2019 Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar i dërgoi



Nr. 112 i Vendimit data 27.03.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfuara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018.

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve listën e përbërë nga 153 ekspertë kontabël të Liçensuar të cilët plotësonin kriteret e kërkuara, bashkëlidhur kësaj dhe listën prej 15 ekspertë kontabël të Liçensuar për të cilët rekomandon të përfshihen në short, por kriterin e eksperiencës 5 vjeçare në ushtrimin e profesionit të ekspertit kontabël e plotësojnë më datën 28.03.2019.

Në mbështetje të germës "c", "d" dhe "e", të nenit 4 dhe nenit 5 të udhëzimit nr. 8, datë 25.03.2009 të ndryshuar, KQZ i kërkoi ekspertëve kontabël të përfshirë në listën e përzgjedhur të depozitonin në KQZ kërkesën për pjesëmarrje në short, si dhe deklaratat personale për plotësimin e kriterëve të parashikuara në dispozitat e mësipërme.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit, si dhe në përmbushje të detyrimit administrativ për njoftimin e palëve, ka bërë njoftim publik disa herë për pjesëmarrje në këtë procedurë për të gjithë ekspertët kontabël të licensuar. Ky njoftim publik është realizuar nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit, por edhe nëpërmjet mediave vizive. Në përfundim të procedurave për përzgjedhjen e listës së ekspertëve kontabël të licensuar, pranë Komisionit Qendror i Zgjedhjeve janë depozituar 23 kërkesa për pjesëmarrje në short.

Nga verifikimi i kërkesave të paraqitura, rezultoi se 21 ekspertë i plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 23/2, pika 1, të ligjit për Partitë Politike, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 8, datë 25.03.2009, i ndryshuar, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 2 prej eksperteve kontabël znj.Enkeleda Alite dhe znj.Sherife Hoxha, kriterin e eksperiencës 5 vjeçare në ushtrimin e profesionit e plotësojnë më datë 28 mars 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi të përfshijë në short edhe dy ekspertët, të cilëve ju plotësohet kriteri 5-vjeçar i eksperiencës në momentin e lidhjes të kontratës së shërbimit.

Për sa më sipër shorti për emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar organizohet duke marrë pjesë 112 parti politike dhe 23 ekspertë kontabël të liçensuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 27.03.2019, në prani të përfaqësuesve të partive politike, ekspertëve kontabël të liçensuar, si dhe mediave, organizoi shortin për emërimin e ekspertit kontabël të liçensuar i cili do të auditojë fondet e përftuara dhe të shpenzuara nga partitë politike përkatëse. Procedura e organizimit të shortit u zhvillua sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 8, datë 25.03.2009, i ndryshuar, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në një enë transparente u futën 23 gogla, ku në secilën prej tyre, në një shirit letre është shënuar emri i secilit prej ekspertëve kontabël të liçensuar pjesëmarrës. Në enën tjetër u futën 112 gogla dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 112 partive politike.



Nr. 112 i Vendimit data 27.03.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018.

Gjithashtu, në bazë të pikës 1 të nenit 23/3 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar, përcaktohet se eksperti kontabël nuk mund të auditoj të njëjtën parti dy vjet njëri pas tjetrit.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1 gërma a, të ligjit nr.10019, datë 29.02.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 15/2, pika 2, germa c, neni 23/2, pika 2 dhe neni 23/3 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.02.2011 dhe Udhëzimit nr.8, datë 25.03.2009 "Për miratimin e kriterëve dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore" i ndryshuar, të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, rezultatin e shortit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë rezultatin e shortit dhe të emërojë ekspertët kontabël të cilët do të auditojnë partitë politike për fondet e përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2018 si më poshtë:

1) DORANIN AGALLIU

- 1- Partia e të Drejtave të Mohuara e Re;
- 2- Partia Demokracia e Re Europiane;
- 3- Partia Shqiptare e Rindërtimit;
- 4- Partia Shqiptare Atdheu;
- 5- Partia Lëvizja Elitare Kombëtare;

2) HIDAJETE KRAJA

- 1- Partia Shqipëria e Re;
- 2- Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve;
- 3- Partia Ekologjike;
- 4- Partia e të Majtës Demokratike Shqiptare;
- 5- Partia Personat me Aftësi të Kufizuar;



Nr. 112 i Vendimit data 27.03.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018.

3) ERVIS KRAJA

- 1- Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqipëtar;
- 2- Partia "Forca Rinia";
- 3- Partia Liberale Shqiptare;
- 4- Partia Kristian Demokrate;
- 5- Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori;

4) AFRIM SULI

- 1- Partia e Çështjeve Shqiptare;
- 2- Partia Aleanca për Europën;
- 3- Partia G99;
- 4- Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet;
- 5- Partia Rimëkëmbja Kombëtare;

5) ALIDA DAIJA

- 1- Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare;
- 2- Partia Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare;
- 3- Partia Aleanca Kuq e Zi;
- 4- Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen;
- 5- Partia Socialiste e Vërtetë 91;

6) HAVA MUÇOLLARI

- 1- Partia Socialreformiste e Shqipërisë;
- 2- Partia Ligj dhe Drejtësi;
- 3- Partia Pajtimi Kombëtar;
- 4- Partia për Mbrojtja e të Drejtave të Emigrantëve;
- 5- Partia Lëvizja e Legalitetit;

7) VULLNETARE ÇELA

- 1- Partia Alternativa Liberale e Shqipërisë;
- 2- Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqiptarëve;
- 3- Partia Shkodra 2015;
- 4- Partia Balli Kombëtar;
- 5- Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European;



Nr. 112 i Vendimit data 27.03.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018.

8) NESHAT MAZE

- 1- Partia Triumfi i Legalitetit;
- 2- Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar;
- 3- Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare;
- 4- Partia Aleanca Socialiste Shqiptare;
- 5- Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare;

9) ELEDA DHIMA

- 1- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut;
- 2- Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare;
- 3- Partia Republikane Shqiptare;
- 4- Partia Progresi Social Kombëtar;
- 5- Partia Emigracioni Shqiptar;

10) ENKELEJDA ALITE

- 1- Partia Demokracia Paqësore Shqiptare;
- 2- Partia Demokratike për Vlëra, Mirëqenie e Progres;
- 3- Partia Aleanca Europiane Ekologjike;
- 4- Partia Demokracia Sociale;
- 5- Partia Balli Kombëtar Demokrat;

11) MARGARITA GJERGJI

- 1- Partia Alternative Republikane;
- 2- Partia Lëvizja Shqipëria e Re;
- 3- Partia Ambjentaliste;
- 4- Partia Socialiste e Shqipërisë;
- 5- Partia e të Drejtave të Mohuara;

12) ANIDA NURI

- 1- Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare;
- 2- Partia Liri, Demokraci dhe Etikë;
- 3- Partia SocialDemokrate e Shqipërisë;
- 4- Partia Ora e Shqipërisë;
- 5- Partia Demokratike e Re;

13) HETEM SULA

- 1- Partia Lidhja e Blertë Shqiptare;
- 2- Partia Integritimit Social Shqiptar;



Nr. 112 i Vendimit data 27.03.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018.

- 3- Partia Kombëtare Konservatore Albania;
- 4- Partia Aleanca Kombëtare;
- 5- Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;

14) SHERIFE HOXHA

- 1- Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë;
- 2- Partia Uniteti Kombëtar;
- 3- Partia Zgjidhja;
- 4- Partia Toleranca e Re e Shqipërisë;
- 5- Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar;

15) LEJLA SHAHU (DOBI)

- 1- Partia Sigurise Kombëtare Shqiptare;
- 2- Partia Demokratike Peza Gjirokastra e Shqipërisë;
- 3- Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar;
- 4- Partia Demokristiane e Shqipërisë;
- 5- Partia Shpresa Demokratike;

16) NURIE KRYMI

- 1- Partia Fryma e Re Demokratike;
- 2- Partia Komuniste e Shqipërisë;
- 3- Partia Lëvizja për të Drejtat e Njeriut;
- 4- Partia Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare;
- 5- Partia Mendimi i Djalit të Liberal;

17) EFTALI QIRJAQI

- 1- Partia Përparimi Kombëtar i Shqipërisë;
- 2- Partia Aleanca Popullore;
- 3- Partia për Europianizimin e Integritit të Shqipërisë;
- 4- Partia Aleanca Demokratike Shqiptare;
- 5- Partia e Punës e Shqipërisë;



Nr. 112 i Vendimit data 27.03.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018.

18) FATMIRA KASTRATI

- 1- Partia Lidhja Kombëtare Shqiptare;
- 2- Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar;
- 3- Partia Prosperitetit Demokratik Shqiptar;
- 4- Partia Universale Shqiptare;
- 5- Partia Socialiste e Moderuar;

19) LUAN MUÇA

- 1- Partia Aleanca Nacionale Shqiptare;
- 2- Partia Reformave Demokratike Shqiptare;
- 3- Partia Fronti i Majtë;
- 4- Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane;
- 5- Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare;

20) FLUTURA LUKE

- 1- Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë;
- 2- Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet;
- 3- Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres;
- 4- Partia Demokratike për Ndryshim;
- 5- Partia Konservatore;

21) SHKËLZEN MARGJEKA

- 1- Partia Aleanca Demokristiane Shqiptare;
- 2- Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet;
- 3- Partia Popullore për Drejtësi;
- 4- Partia e Gjelbër;

22) SILVANA GJIKDHIMA

- 1- Partia Socialpuntore e Shqipërisë;
- 2- Partia Demokratike e Shqipërisë;
- 3- Partia Sfidë;
- 4- Partia Aleanca Arbnore Kombëtare;



Nr. 112 i Vendimit data 27.03.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licënsuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018.

23) RAJMONDA REVELI

- 1- Partia Ardhmëria Shqiptare;
- 2- Partia Bashkimi Liberal Shqiptar;
- 3- Partia Lista për Shqipërinë Natyrore;
- 4- Partia e Blertë Shqiptare;

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA-	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 112 i Vendimit data 27.03.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018.